

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 3, datë 24.02.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10¹⁵)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Edison Kapaj | 16.Fatos Rukaj |
| 2.Alboren Aliaj | 17.Teki Xhemalaj |
| 3.Simo Petromilo | 18.Ardian Skëndaj |
| 4.Brunilda Cani | 19.Arben Meksi |
| 5.Adiola Gjoka | 20.Gentian Hamzaraj |
| 6.Kasëm Mahmuti | 21.Eglantina Imeraj |
| 7.Sulltana Bilbilaj | 22.Edlira Kapllanaj |
| 8.Sulejmën Bubeqi | 23.Istref Dobi |
| 9.Ramona Jaho | 24.Liljana Breshani |
| 10.Elona Toçaj | 25.Anxhela Aliraj |
| 11.Frosina Qyrdeti | 26.Jerina Dervishaj |
| 12.Asime Feraj | 27.Kreshnik Tepelena |
| 13.Migena Balla | 28.Rozina Kormuzi |
| 14.Sokol Kushta | 29.Kristaq Meçi |
| 15.Anisa Shametaj | 30.Briseida Çakërri |

Mungojnë :

- 1.Ervis Moçka
- 2.Klearda Rapushi
- 3.Ina Islamaj
- 4.Brunilda Saliaj

5. Julian Blea
6. Klara Bajaziti
7. Lindrit Beqiraj
8. Grigor Dede
9. Roneda Muçaj
10. Rudi Pashaj
11. Mujo Shakaj
12. Pëllumb Nezha
13. Paula Sullaj
14. Evis Allushi
15. Besian Gega
16. Bujar Osmanaj
17. Jonela Halili
18. Ervis Caushaj
19. Andi Resulaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/1, datë 24.02.2023

Znj.Migena Balla - Të nderuar këshilltarë ! Fillojmë mbledhjen . Siç jeni njohur me materialet në postën elektronike , kjo mbledhje kishte ne rend dite 9 pika . Në mbledhjen e kryesisë, janë shtuar dhe 4 projekt vendime për emërtime rrugësh dhe për një korrigjim, emërtimi rruge.

Sot, ka ardhur dhe një projektvendim nga emergjencat , në lidhje me rikonstruksionin e pallatit Nr 1300. Jemi njohur me këtë si problematikë, sot do ti japim zgjidhje.

Z.Ardian Skëndaj – Projekt vendimi për zonjën Ervehe Çela ...

Znj.Migena Balla – Nuk ka ardhur si projekt vendim, jam dakort . Është vetëm ndryshim.

Z.Ardian Skëndaj – Është vetëm ndryshim.

Znj.Migena Balla – Në lidhje me shprehjen e ligjshmërisë, për vendimet e mbledhjes së kaluar, janë shprehur të ligjshëm, nga institucioni i prefektit të qarkut.

Hedhim në votë rendin e ditës me projektvendimin e pallatit nr 1300 në lagjen “24 Maji”.

Pro – të gjithë.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet .

Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së këshillit datë 18 dhe 31 janar 2023 .

Votohet.

Pro – 29 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/2, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin janar 2023”.
Nga administrata, një relacion.

Znj.Irena Stasa – Ndhmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë përfitojnë, 28 familje në rajonet
e bashkisë Vlorë dhe njësitë administrative..., Gjithsej janë 40 familje në njësi dhe rajone.
-7 familje të mos trajtohen dhe 8 familje që hyjnë për herë të parë në skemën e ndihmës
ekonomike.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime? – Jo.

E hedhim në votë.

Pro – 29 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/3, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin janar 2023”.

Znj.Irena Stasa –Janë 5 familje që përfitojnë nga fondi i kushtëzuar , nga granti i qeverisë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? – Jo.


Votohet.

Pro – 30 vota(vjen znj.Briseida Çakëri)

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota .

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/4, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e dokumentave të punës , për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen “.

Znj.Irena Stasa – Bashkia Vlorë dhe Bashkia Korçë, janë bashki që e aplikojnë, është dokumentacioni që ne do punojmë. I kemi bashkëlidhur të gjitha dokumentat.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime? – Jo.

Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/5, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit“ Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve me probleme të thella social ekonomike që do të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë për një periudhë 10 mujore, me të ardhurat e bashkisë “.

Znj.Irena Stasa – Është për të falënderuar grupi i aleancës së grave këshilltare , në lidhje me këtë nismë, me këtë projekt . Bashkia Vlorë, e ka si traditë që nxjerr fond për këta fëmijë, për 16 familje për kopshte dhe çerdhe, për një periudhë 10-mujore falas, fëmijë nga familje me probleme të thella social ekonomike. Janë këto verifikime shumë të sakta. Është dhe një kërkesë nga zonja Edlira që, muajin tjetër do ta vëmë.

Z.Kasëm Mahmuti – Pika 3 duhet sistemuar pak, le të shënohet data e fillimit. Është përmendur në dy pikat më parë, të sistemohet.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? – Jo.


Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/6, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese për “Programin e përmirësimit të kushteve të banesave egzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara “për vitin 2023.

Një relacion nga administrata. Kemi dhe pikën 7 që janë të lidhura këto projektvendime.

Znj.Drita Mustafai – Drejtorja e infrastrukturës , është paraqitur me 2 projektvendime.

Projektvendimi i parë, është për miratimin e deklaratës dhe projektvendimi i dytë ,për miratimin e listës së familjeve përfituese, për programin e përmirësimit të kushteve të banesave egzistuese për komunitete të varfëra. Bazuar kjo në ligjin “Për strehimin social”, shkresën e Ministrisë së Financave dhe kërkesave nga qytetarët që banojnë në banesa me kushte të këqija ..., bazuar në ligj...

Shkresa e ministrisë së financave ka dhe referencat, ne kemi aplikuar. Afati përfundimtar pranë ministrisë së financave, ishte 31 janar 2023, por si fillim duhet miratuar nga këshilli bashkiak.

Znj.Rozina Kormuzi – Në lidhje me miratimin e listave të këtyre familjeve... Në rajonin nr 4, janë 2 familje në listë, numër shumë i vogël.

Në vazhdimësi familje të tjera, mund të aplikojnë më vonë, ndonjë projekt për komunitetin rom dhe egjyptian.

Znj.Drita Mustafai – Aplikimet bëhen gjatë gjithë vitit, me kërkesën pranë drejtorisë së informacionit. Pastaj , i dërgohen ministrisë së financave dhe, përfitohet nga bashkitë, sipas projekteve.

Znj.Migena Balla – Pra, si aplikim gjatë gjithë vitit, por fondi nga ministria,1 herë në vit.

Znj.Drita Mustafai – Shikohet pronësia dhe të ardhurat.

Z.Ardian Skëndaj – Dua të pyes se ka patur dhe programe të tjera. Nuk ka ardhur ndonjë relacion përfundimtar. Kemi miratuar, por nuk e dimë si ka funksionuar, çfarë është bërë ?

Kemi miratuar fondin, lekët, le të jepet llogari. Është bërë tenderimi dhe, nuk është bërë siç duhet puna. Të më japë 2 projektvendimet e fundit, procesverbalet e shtëpive, relacion. Çfarë janë dorëzuar me procesverbal ..Është bërë tenderimi..., por më pas....

Znj.Migena Balla – Flas për bllokimin që tju bëjmë këtyre familjeve. Jam dakort për relacionin dhe, ta mendojmë dhe një herë për bllokim.

Z.Ardian Skëndaj - Për mua, janë bërë fiktive.

Z.Fatos Rukaj – Tek kjo listë, rreshti 2 dhe 3, është përmendur 2 herë. Një saktësim, është e njëjta godinë.

Znj.Drita Mustafai – Janë familje të ndryshme.

Z.Fatos Rukaj - Bashkëfinancues....

Znj.Drita Mustafai - Janë në të njëjtën çati, por familje të ndryshme.

Z.Ardian Skëndaj - Kur do vijë relacioni për projektet e mëparëshme, bashkë me procesverbalet e dorëzimit.

Znj.Drita Mustafai – Në mbledhjen e ardhëshme, do të sjellim dhe foto.

Z.Daut Zëraj - Këto projekte janë me bashkëfinancim me ministrinë. Këshilli dhe administrata, kanë të njëjtin qëllim. Kush shkel ligjin, përgjigjet.

Proçedurat, nga miratimi i fondit, prokurimi..Është e njëjta proçedurë për të gjitha projektet.

Ne jemi të detyruar të japim informacion.

Znj.Migena Balla – Ka ndonjë pyetje, diskutim tjetër ?

Z.Sulejmën Bubeqi – Mund të ngrejmë një grup, një komision për të kontrolluar dhe parë punën, por jo për të bllokuar.

Znj.Migena Balla - Jeni dakort, të mos ta votojmë sot, ta bllokojmë ?

Do vëmë kusht relacionin? Të silllet relacioni. Do ta kalojmë projektvendimin ?

Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.

Pra, relacionin na e sillni dhe më shpejt se mbledhja, në rrugë elektronike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/7, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla - Votojmë për pikën 7 të rendit të ditës, projektvendimin “Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për “Programin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara “.


Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 3/8-9-10-11, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës, në miratimin e rojektvendimit “Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Vlorë”. “Brigada e nëndetëseve”, në njësinë Orikum .

Z.Ardian Skëndaj – I kalojmë të tre projektvendimet, relacionet kanë ardhur.

Znj.Migena Balla – Për hir të këtyre njerëzve të nënujit , është propozim i tyre. Edhe unë jam vajzë nënujësi. E kam ndjerë mungesën e babait tim . Ata që e kanë jetuar. Është një historik i gjithë punës së tyre.

Pika 9, është për emërtim rruge “Erid Hamzaraj”

Pika 10, është emërtim rruge “Azis Hasa “

Pika 11, është thjesht një korigjim nga atësi në mbiemër ,”Yzeir Skëndo Ilazaj “.

Pra, kalojmë pikat 8,9,10 dhe 11 të rendit të ditës.

Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohen pikat 8, 9, 10 dhe 11.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/12, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në projektvendimin “Për rikonstruksionin e pallatit Nr 1300, në lagjen “24 Maji “. Është shumë problem emergjent. Jemi në dijeni .
Kush ka pyetje, diskutime ? - Jo, ska.

Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 3/13, datë 24.02.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën , informacion nga administrata për shkresat e ardhura nga prefekti i qarkut Vlorë , si problematike dhe emergjente (Verifikim dhe marrje masash urgjente për dëmtime të konstruksionit të pallatit nr 459 dhe, Për godinat dhe veprat e artit rrezik shembje ose me problematika të qëndrueshmërisë) Çfarë është bërë ?

Z.Teki Xhemalaj – Sot po miratojmë një fond për rikonstruksion pallati. Por, sa të tillë do të ketë? Kemi miratuar rregulloren për administratorët e pallateve, që nuk po funksionon. Pra, administrata, administratorët, kryetarët e rajoneve dhe këshilltarët , të bëjnë një model dhe të shihet për të gjithë pallatet që duhen rikonstruktuar, pra kë mund të bëjmë dhe kë, jo.

Z.Sokol Kushta – Mbështes zotin Teki . Kryetarja e rajonit erdhi, kanë filluar pastrimi, riparimi i difekteve. Është gjë pozitive, filloi. Zoti Teki , ka të drejtë.

Z.Teki Xhemalaj - Kryetarja e rajonit, le të japë mendimin dhe përvojën e saj. Të sensibilizohen të gjithë dhe të vazhdojë kjo punë.

Z.Sokol Kushta – Ne kemi ndjerë dhimbje në kurrizin tonë, duhet mbështetje nga bashkia.Është diçka pozitive dhe do ta mbështesim.

Znj.Migena Balla – Është për ambjentet e brendshme, taksa nuk është ...

Znj.Frosina Qyrdeti – Taksa për pastrimin, paguhet nga të gjithë, jo taksë tjetër. Flasim për rrugët e lagjeve.

Z.Sokol Kushta – Unë e quaj pozitive. Ne themi , si ta ndihmojmë firmën e pastrimit.

Znj.Frosina Qyrdeti - Flitet për qytetin. Për mirëmbajtje të brendëshme

Znj.Migena Balla - Administrimi i pallateve, është shumë problem.

Z.Teki Xhemalaj - Po flasim për dy pika të ndryshme.Administrimi i pallatit brenda...tarifa që thotë zoti Sokol , mund të jetë e përshtatëshme . Gjithë pallatet kanë nevojë për mirëmbajtje.

Mund të themi dhe për ashensorin dhe, këta janë për rikonstruksion. Pra, kush jemi neNe jemi ata që 90% të ashensorëve , e kemi bërë me çip, pra, nuk paguhen rregullisht. Pra, të sensibilizohemi...

Znj.Liljana Breshani – Problemi i administratorit të pallatit, është mëse i nevojshëm , është mëse e domosdoshme, të paguhet dhe me një cilësi shumë të lartë. Pra, të jetë një fenomen detyrues. Ka mangësi dhe jemi shumë vonë.

Znj.Frosina Qyrdeti - Rregullorja që ne kemi bërë, për administratorët e pallateve , ka nevojë të rregullohet..., të bëhet shtesë...Kush është roli i këshillit bashkiak ?

Z.Arben Mexsi – Kisha 3 problematika, për të diskutuar.

-Para pak, kishim festat dhe shumë pyesnin për shtatoren e Isa Boletinit . Tani sheshi ka mbaruar . Në krah të Ismail Qemalit është Hasan Prishtina. Do të propozoja që në krah të tyre , të vihet busti i Isa Boletinit.

-Stacioni i trenit, e kam diskutuar shumë herë. Çfarë po bëhet? Është lënë 30 vjet e pashfrytëzuar kjo godinë. Pse mos të ndryshojë , të bëhet Propozoj ti shkruajmë qeverisë, deputetëve, çfarë do të bëhet..

-Shikoj disa gropa tek hotel “Partner”. Kaq keq jemi, që ti bëjë bashkia... Ti mbushë këto gropa...Kush i shikon këto ?

-Lagjja e Saliavje dhe e Velajve, problem 200÷300m pa ndriçim...pak lekë janë..., është shqetësim.

Z.Sokol Kushta – Dua të falënderoj zotin Istref, zonjën Jonela, zotin prefekt, për vizitën me rastin e 15 vjetorit të pavarësisë së Kosovës, në Mitrovicë. Mikpritje model. Më bëri përshtypje edukata parlamentare, kryetari i bashkisë, salla...Faleminderit të gjithë pjesëmarrësve dhe ata që na ftuan.

-Doja të thosha tjetër, ka shumë prindër që ankohen për fushën mbas pallatit të sportit..., sheshi është zënë, është bërë parkim.

Z.Kasëm Mahmuti - Dua të tërheq vëmendjen...Në datën 24 mars , përfundon kontrata e shërbimit të pastrimit për Orikumin. Do të doja informacion nga bashkia, si do të zgjidhet pastrimi pas kësaj date.

-Jemi në fund të muajit Shkurt . Duhet të kishim një plan për sezonin turistik.

- Ne kemi diskutuar në lidhje me spostimin e parkimit, për autobëzët e linjave dërkombëtare, për lirin e tij ...Një vendim të këshillit, nuk e zbatojnë . Ku e gjejnë kurajon? Është kaos. S’është bërë asgjë. Pse nuk është zbatuar? Na u tha do ta shtronte, do ta ndryshonte. E rikthej shumë i indinjuar në kujtesë këtë fakt.

Z.Daut Zëraj – Kontrata është në përfundim, kontrata e pastrimit për Orikumin....ne nuk ikëm me mendimin se çfarë do të bëhej me përfundimin e Landfilldit....Do fillojë procedura e prokurimit.

Z.Ardian Skëndaj – Kemi kërkuar një strategji.

Z.Daut Zëraj – Strategjia vihet nga Landfilldi. Strategjia , është e ndërvarur dhe nga Landfilldi. Shërbimi i pastrimit, është çështje ditësh për Orikumin, po ecim me procedurat.

Z.Kasëm Mahmuti – Nuk ishte përgjigje..Nuk ka zgjidhje.

Tek faqja e publikimeve në APP, nuk kishte shpallje.

-Të jetë pjesë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme .Nëqoftëse do të ketë shtesë kontrate 20% dhe, si është zbatuar kjo kontratë 3-vjeçare. E dua me shkrim nga drejtori përkatës.

-Kontrata do të shtohet 20%, sepse 1,2,3.... dhe, varianti tjetër të mbulohet nga shërbimi, sektori i pastrimit të bashkisë.

-Kostot për njësi nga ky shërbim?

Qytetarët e duan qytetin të pastër.

Pra, zonja kryetare, zoti kryetar i grupit, e dua materialin, relacionin në rendin e ditës.

Z.Ardian Skëndaj - Kam nja dy kërkesa dhe dua përgjigje nga zonja zëvendëskryetare.

-Pse vazhdojnë të gënjehen njerëzit për banesat sociale, me kosto të ulët? Pse është bllokuar procedura?

Si po vazhdon kjo procedurë? Cili është roli i kryetarit të bashkisë në pengesën e kësaj procedure. Problematikën po e ndjek nga afër. Po degradohet.

Çfarë do bëhet? Kur do vijë banesat për tu ndarë në këshill?

Znj.Aulona Veizi – Do interesohem dhe do kthejmë përgjigje.

Z.Ardian Skëndaj - Ka një dashkeqësi, po degradon. Po rritet kostoja. Zonja Drita, si do bëhet

Znj.Edlira Kapllanaj – Ne dijmë se po vazhdojnë procedurat.

Znj.Ardian Skëndaj – Më thuaj maksimumin.

Znj.Aulona Veizaj – Në fund të muajit, në mbledhjen e ardhshme.

Znj.Edlira Kapllanaj – Këto burokracira..

Z.Ardian Skëndaj – Është turp. Shtëpitë e fukarenjve do mbajmë...Do ktheni përgjigje brenda javës...Kjo bashki ka degraduar. Brenda 10 ditësh, relacion. Cili është roli i kryetarit të bashkisë në pengesën e kësaj procedure. Po tallen me njerëzit në nevojë.

-Në disa vende , janë bllokuar trotuarët fare. A paguajnë tatimet këta ? Nuk paguajnë asnjë taksë. Qytetarëve u merret fryma për taksat, ndërsa këta nuk paguajnë taksat. Konkretisht tek “3Racat” është zënë trotuari.

-Tjetër, tabelat pa leje, nuk paguajnë taksat. Asnjë taksë nuk paguhet. Kur do na jepni përgjigje, zonja nënkryetare ?

Znj.Aulona Veizi – Të dyja informacionet, do ti nisim brenda 10 ditësh.

Znj.Migena Balla – Banorët, për të ndjekur mbledhjen, është e hapur. Por, për të folur, duhet të kishin depozituar kërkesë pranë këshillit bashkiak. Ju lutem, mbani qetësi.

Z.Ardian Skëndaj - Afati, kur do të hiqen këto tabela ,ose paguajnë taksat..

Znj.Aulona Veizi - Brenda 10 ditësh , do të japim informacion.

Z.Ardian Skëndaj - nëqoftëse, mblidhen, ku shkojnë këto lekë ?

Zoti Daut, në lidhje me buxhetin për mediat për këshillin bashkiak..Çfarë është bërë ?

Z.Daut Zëraj – Çfarë duhet të bëhet? Kur të bëhet buxheti shtesë, do planifikohet, por këshilli nuk ka asnjë pengesë .

Z.Ardian Skëndaj – Kur do vijë ky buxhet shtesë ?

Z.Daut Zëraj - Është procedurë që s'varet vetëm nga ne, por dhe nga Dega e Thesarit.

Z.Ardian Skëndaj – Është miratuar struktura, 20 punonjës tek zjarrfikësja . E miratua. Çfarë po bëhet me këta. Pse i gënjeni njerëzit ?

Znj.Edlira Kapllanaj – Doja të falënderoja kryetarin e grupit socialist në lidhje me ndarjen e banesave me kosto të ulët. Flas në emër të komunitetit . Janë njerëz që kanë shumë nevojë. Të shpejtohet kjo procedurë. Kjo procedurë ka ndaluar.

Nëqoftëse, është bërë pengesë kryetari i bashkisë, po i drejtohem...Ju lutem zoti kryetar!

Shpejtoni procedurat e ndarjes së banesave me kosto të ulët. Nëqoftëse, në lidhje me komisionin do të ketë problem

Të vazhdojë procesi i ndarjes së banesave me kosto të ulët. Ju lutem, pse është penguar ? Janë shumë që flenë jashtë. Ju lutem, të vazhdojë procesi i ndarjes së këtyre banesave.

Z.Simo Petromilo - Të nderuar këshilltarë ! Jemi në fund të mandatit dhe secili nga ne bën bilancin. Shumë nga kërkesat dhe vërrejtjet e bëra nga ne , kanë ngelur rrugës dhe, si shumë nga vendimet e këshillit bashkiak kanë ngelur në letër, pa u zbatuar.

Në mbledhjen e kaluar, ngrita problemin e 2-3 rrugëve, ankesë e qytetarëve...tek rruga e serave dhe, sot nuk është vënë dorë. Unë e shikoj që nga administrata e bashkisë nuk ka kush të dëgjojë. Por, zonja nënkryetare! Tu hiqet veshi për punën e dobët dhe, ti kalojnë drejtorive përkatëse.

-Vërrejtje, ose kërkesë. Ne të gjithë kemi drejtuar dikur punët, pra, bëhet një kalendar pune. Si për krahasitjen e pemëve

Buxheti i vitit të kaluar..Atje ishte përmendur që, krahasitja e pemëve, ishte bërë 100%...Duhet filluar krahasitja. Drejtoria përkatëse, të marrë sa më shpejt masa.

Znj.Asime Feraj – Kisha 2 probleme.

Projektvendimi që sapo miratua, për emërtimet e rrugëve, ka dhe një problematikë , ku shkruhen me shumë gabime. Si dhe në shumë tabela orjentuese në qytet. Është shumë shqetësuese.

-Kemi sezonin turistik, sikurse projektvendimi për emërtimet e rrugëve , bashkia të sjellë projektvendim për rregullimin e tabelave orjentuese në qytet.

-Miratimi i projekt buxhetit, ku tregon shtesë në buxhet, ku do të merren parasysh këto planifikime dhe problematika që nuk ishin të planifikuara në buxhet.

Znj.Migena Balla – Nëqoftëse, s'keni pyetje e diskutime të tjera, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbajti Procesverbalin

Zhaneta Gjika